

## RAPORTI VJETOR

2019



**Përgatiti Raportin:**

*Shpresa BANJA; Nertila TOLI; Dhoksi GJOKA; Mirela GJONI; Soela KURTI;  
Gertjana HASALLA; Valmira PAJENGA*

*Janar, 2019*

## HYRJE

Paraqitja grafike e mbështetjes së ofruar nga donatorët për vazhdimësinë e punës së Forumit të Gruas Elbasan jepet më poshtë në vijim të **Tabelës nr.1** me specifikimin e donatorit përkatës, projektit të zbatuar ose në zbatim dhe shumës së akorduar në Lekë. **Grafiku nr.1** bën një shpërndarje të përqindjes që secili prej këtyre projekteve zë në buxhetin vjetor të FGE.

**Tabela 1**  
**Projekte të financuara gjatë Vitit 2019**

Nr i Projektëve	Emri i Organizatës Financuese	Titulli i Projektit	Shuma e akorduar në Lekë
1	AWEN - RRJETI I FUQIZIMIT TE GRUAS NE SHQIPERI	"Akses i përmirësuar për gratë dhe vajzat, të mbijetuara nga dhuna në Qarkun e Elbasanit"	3,209,370
2	UNTF - UNITED NATIONS TRUST FUND	"Aksesi i përmirësuar për gratë dhe vajzat të mbijetuara nga dhuna në Qarkun e Elbasanit"	6,114,042
3	UNW – UN WOMEN ALBANIA npm fondeve të EU Commission	"Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi efektet dhe adresimin e stereotipeve të dëmshme gjinore, si burim i dhunës ndaj grave në rajonin e Elbasanit"	2,184,044
4	USA - PUBLIC AFFAIRS SECTION, US EMBASSY TIRANA	WIN (Women that Inspire Novelty) Gratë që inspirojnë risi"	276,815
5.1	UNDP/ReLOaD	"Fuqizimi dhe ri-integrimi i grave/vajzave të mbijetuara të DHBGJ/DHF në Bashkinë Elbasan"	1,074,134
5.2	UNDP/ReLOaD	"Fuqizimi dhe ri-integrimi i të rinjve në Bashkinë Prrenjas"	1,250,185
6	SCPA/FCG Swedish Development AB	"Ndërveprim mes Policisë së Shtetit, aktorëve lokal dhe komunitetit në lidhje me DHF dhe DHBGJ"	562,090
7	WORLD VISION ALBANIA	Kampi Veror "Të ndryshëm, por të Barabartë"	290,650
TOTALI I PËRGJITHSHËM			14,961,330

**Grafiku 1**  
**Paraqitja grafike e të dhënave të Tabelës nr. 1**



Gjatë vitit 2019 veprimtaria e Forumit të Gruas Elbasan (FGE) është fokusuar në tre shtylla kryesore si më poshtë:

- a) Shërbime konkrete në favor të grave dhe vajzave;
- b) Fushata sensibilizuese;
- c) Trajnime dhe ngritje kapacitetesh.

#### **a. Shërbime**

Shërbimet konkrete për gra/vajza me probleme dhune realizohen nga:

- 1. Qendra e Këshillimit**, ofron shërbime falas në ndihmë të grave/vajzave me probleme dhune dhe social-ekonomike në Qarkun e Elbasanit, por edhe nga Qarqet e tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Shërbimet e ofruara nëpërmjet psikologes/punonjësese sociale, janë:

- Mbështetje psikologjike, sociale, individuale dhe në grup;
- Ndërmjetësim me familjarët dhe përfituesit për gjetjen e alternativave drejt zgjidhjes së problemeve;
- Ndërmjetësim në qendrën e Formimit Profesional, në Biznesin Lokal;
- Informim, orientim dhe referim të rasteve për shërbime të tjera alternative të nevojshme të ofruara nga aktorë të tjerë vendor (publikë dhe jopublikë).

**Gjatë periudhës 01 Janar – 31 Dhjetor 2019** në total janë ofruar **728** këshillime psikologjike, nga këto:

- **288 këshillime nëpërmjet linjës telefonike**, ku nëpërmjet numrit të telefonit +355 69 65 11 674 përfitueset prezantojnë problemet e tyre duke mbetur anonim.
- **440 këshillimit ballë për ballë**, ku vajzat/gratë vijnë direkt në Qendrën e Këshillimit dhe bëjnë prezente problemet dhe shqetësimet e tyre.
- **161 pyetësorë** të plotësuar nga përfitueset për të identifikuar nevojat e tyre, në strehim, punësim etj.

- 2. Studio Avokatore** është e vetmja në Qarkun e Elbasanit që ofron shërbim ligjor falas. Shërbimet më konkretisht janë si më poshtë:

- **205 konsulenca ligjore** me objekte të ndryshme. Këto konsulenca u janë ofruar përfitueseve që kanë dashur të marrin vetëm informacion ligjor;
- **65 dosje ligjore** të çelura për përfaqësim në gjykatë;
- **138 akte ligjore** të hartuara për procesin gjyqësor dhe kërkesa drejtuar institucioneve të tjera.
- **352 konsulenca ligjore** brenda dosjeve ofruar para dhe pas seancave gjyqësore;
- **158 përfaqësime** në gjykatë me avokat.

**3. Qendra e Kujdesit Ditor (strehëz emergjence)** është e vetmja në gjithë Qarkun Elbasan. Kjo qendër lindi si nevojë e asistimit dhe mbështetjes së grave të dhunuara të cilat denoncojnë dhunuesit e tyre, janë në rrezik e kërkojnë të pajisen me Urdhrin e Menjëhershëm të Mbrojtjes.

Shërbimet e ofruara nëpërmjet punonjësese sociale janë:

1. Strehim nga disa orë deri në 5 ditë, në pritje të marrjes së Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, për vajza/gra dhe fëmijët e tyre nën 18 vjeç.
2. Vazhdim i këshillimit psiko-social-ligjor e mjekësor nga QK dhe SA-ja gjatë ditëve të akomodimit.

Gjatë kësaj periudhe në QKD janë akomoduar **45 gra/vajza** dhe **39 fëmijë** të grup moshave të ndryshme.

Konkretisht nga **45** raste, **27** janë referuar nga policia, **10** nga Bashkitë e Qarkut Elbasan, **2** nga Institucioni i Prefektit Elbasan, **4** nga OJQ, **2** nga qytetarët dhe ish- përfituesit dhe **12** u vetë-referuan. Për herë të parë ka pasur 12 raste të referuara pas forumeve ndërgjegjësuese të mbajtura në komunitet. Duhet të përmendet se nga rastet e akomoduara, **10** kanë qenë nga komuniteti egjiptian dhe **2** nga komuniteti rom.

Janë realizuar gjithashtu:

- ✚ **4 sesione fuqizimi** për vajzat dhe gratë të mbijetuara të dhunës janë mbajtur me qëllim fuqizimin e tyre dhe dhënien e informacionit mbi çështje të lidhura punësimin, strehimin, të drejtat pronësore dhe ndihmën ekonomike. **75** përfituese të shërbimeve të FGE kanë qënë pjesë e këtyre sesioneve për të thyer ciklin e dhunë sdhe për tu ri-integruar në shoqëri. Për shkak të konfidencialitetit të grave/vajzave nuk realizohen apo publikohen fotografi të sesioneve.
- ✚ Për ti ardhur në ndihmë viktimave të dhunës në familje sipas problematikave të ngritura nga ato, gjatë këtij viti janë realizuar **4 Rrjete Rajonale** me pjesëmarrjen e **110** aktorëve lokal nga gjithë Qarku Elbasan.





- + **Funksionimi i Komitetit Drejtues në Bashkine Belsh dhe Gramsh** në kuadër të projektit të *Policimit në Komunitet*; Pas ngritjes së Mekanizmit të Referimit, Kryetari i Bashkisë Belsh ka realizuar dy takime me komitetin drejtues, një në datën 26 Nëntor 2018 dhe një në datën 19 Mars 2019 me pjesëmarrjen gjithashtu të vlerësueseve të jashtme Suedeze.



- + **3 takime të Grupit Multidisiplinar për Referimin e rasteve të Dhunës në Bashkinë Belsh dhe Gramsh**, në kuadër të projektit të *Policimit në Komunitet* u realizuan gjatë këtij viti për të sjellë sëbashku të gjithë aktorët lokalë, përfaqësues institucionesh publike dhe jo-publike në mënyrë që të rritet aksesin në shërbime për të mbijetuarat e dhunës. Gjithashtu, është realizuar një takim për shkëmbimin e eksperiencave mes tre grupeve multidisiplinare të Bashkisë Elbasan, Belsh dhe Gramsh.



- + **Mbështetje konkrete të rasteve të mbijetuarve të dhunës** në familje për ti ri-integruar në shoqëri. Gjatë vitit 2019 janë mbështetur në total **55** gra/vajza të mbijetuarat të dhunës në familje në Qarkun Elbasan me pagesën e taksave në gjykatë, pagesën e psikologut, në marrjen e një profesioni (kurs kuzhine),

përgatitjen e dokumentave, vizitave për përfitimin e KEMP-it dhe bërjen e analizave të SST-ve, me pajisje elektro-shtëpiake dhe me paketa ushqimore.

### b. Fushata sensibilizuese

FGE është një ndër organizatat më aktive në organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit. Në kuadër të disa projekteve të mbështetura nga UN WOMEN, SIDA npm programit të Policimit në Komunitet, UNDP npm programit ReLoad, Rrjeti i Fuqizimit të Gruas Shqiptari (AWEN), Ambasada Amerikane npm Skemës së Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci etc. që po zbaton, ka realizuar Forume në Komunitet dhe Takime Ndërgjegjësuese me të rinjte në të gjithë Qarkun e Elbasanit. Konkretisht, përgjatë vitit **2019** janë realizuar:

- ✚ **15 forume në komunitet** me një total prej **569** pjesëmarrësish ndër të cilët **397** gra/vajza dhe **172** burra/djem të realizuar në të gjithë Qarkun e Elbasanit që përfshin 7 bashki (Elbasan, Cerrik, Prrrenjas, Gramsh, Belsh, Librazhd dhe Peqin). Në forume u diskutua mbi stereotipet e dëmshme, rolet gjinore, parandalimin e dhunës në familje, shkaqet dhe pasojat dhe si mund të përmirësojmë situatën e dhunës.







- ✚ **82 takime ndërgjegjësuere me 1992 rinj (1218 vajza dhe 774 djem) në shkolla të arsimit parauniversitar dhe 2 leksione të hapura në universitet (136 studentë) janë organizuar në Belsh, Prrenjës dhe Elbasan. Qëllimi i këtyre takimeve ishte rritja e ndërgjegjësimit mbi dhunën në familje, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën mes të rinjve.**



*Leksione të hapura me studentë*



*Takime ndërgjegjësuere me të rinj (Policimi në komunitet)*



*Takime ndërgjegjësuere me të rinj (ReLOad Prrenjës)*



*Takime ndërgjegjësues me të rinj (ReLoad Elbasan)*



*Takime ndërgjegjësues me të rinj (Projekti WIN)*

- ✚ **5 Forume Publike** me anëtarë të 5 komuniteteve fetare në Qarkun e Elbasanit (Musliman, Katolik, Orthodhoks, Evangjelic dhe Bektashi) me në total **139** pjesëmarrës ndër të cilët **95** gra/vajza dhe **44** burra/djem. Përveç dhunës në familje, në fokusin e forumeve publike ishin të gjitha format e dhunës ndaj grave siç kërkohet nga Konventa e Stambollit, përfshirë dhunën seksuale, ngacmimin, martesën e detyruar, etj. Diskutimet në komunitet u përdorën për të adresuar të drejtat e njeriut të grave dhe çështje të barazisë gjinore në kontekstin e marrëdhënieve familjare, arsimit, pronës, pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike dhe fusha të tjera.





- ✚ **5 Takime ndërgjegjësuere me djem/vajza** anëtarë të 5 komuniteteve fetare në Qarkun e Elbasanit (Musliman, Katolik, Otrodoks, Evangjelic dhe Bektashi) me në total **142** pjesëmarrës ndër të cilët **75** vajza dhe **63** djem. U diskutua gjithashtu për edukimin specifik të djemve dhe vajzave nga komunitete specifike dhe u gjetën pika takimesh me secilën prej tyre me qëllim që të diskutohej dhuna midis të rinjve, efekti i të jetuarit në një mjedis të dhunës në familje dhe stereotipet ekzistuese në shoqëri. Në këto takime ndërgjegjësuere u diskutua gjithashtu për të gjitha format e dhunës ndaj grave siç kërkohet nga Konventa e Stambollit, përfshirë dhunën seksuale, zënkat, ngacmimet, martesën e detyruar, etj.



- ✚ **Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, më 8 Mars 2019**, Forumi i Gruas Elbasan organizoi një aktivitet ndërgjegjësuere në kuadër të projektit "Rritja e ndërgjegjësimin të komunitetit mbi efektet dhe mënyrën e trajtimit të stereotipeve të dëmshme gjinore në rajonin e Elbasanit". Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte promovimi i "të drejtave të barabarta të pronës për gratë dhe vajzat". Aktiviteti u organizua me gra dhe vajza, të mbijetuara nga dhuna, përfituese të shërbimeve FGE nga i gjithë Qarku i Elbasanit. Pas një mbledhje në sheshin kryesor të qytetit të Elbasanit me gra përfituese ku tullumbacat portokalli u hodhën në ajër si

simbol i lirisë, prefekti i Elbasanit, **Z. Gledian Llatja** na u bashkua dhe dha një intervistë për median lokale me mesazhe në lidhje me të drejtat e grave. Ai ishte gjithashtu pjesë e takimit ndërgjegjësues ku të drejtat e pronës së grave u diskutuan me pjesëmarrësit dhe premtoi të llobojë me institucionet shtetërore për të përmirësuar gjendjen e grave në Qarkun Elbasan.



- ✚ **Emision dhe spot televiziv për policimin në komunitet;** Në kuadër të këtij projekti u realizua **një emision dhe një spot** në një nga TV lokale që ka shikueshmërinë më të lartë në Bashkinë Belsh. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ndërgjegjësimi dhe informimi i opinionit publik mbi funksionimin e mekanizmit, dhunën në familje dhe rëndësinë e policimit në komunitet në partneritet me policinë, bashkinë dhe aktorët e tjerë lokal. Spoti është ndarë në youtube dhe në të gjithë rrjetet sociale të Forumit dhe të institucioneve. Lidhja e publikimit në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=dn1OHxhvk&t=5s>  
Fotografitë gjatë xhirimit të videos ndërgjegjësuese:



- + **Video ndërgjegjësuere për 16 Ditët e Aktivizmit;** Realizimi i kësaj video ndërgjegjësuere synonte të rriste ndërgjegjësimin e sa më shumë njerëzve në komunitet. Ajo përfshinte të pesë udhëheqësit e bashkësive fetare në Qarkun e Elbasanit (komuniteti Katolik, Ortodoks, Ungjillor, Musliman dhe Bektashi) dhe të rinjtë nga këto bashkësi fetare për të përhapur mesazhe kundër dhunës, stereotipeve të dëmshme gjinore dhe mentaliteteve të vjetëruara. Ofruesit e shërbimeve në Elbasan dhe aktorët vendas u përfshinë gjithashtu në realizimin e videos së ndërgjegjësimit, si infermieret, oficerët e policisë dhe kryetari i bashkisë, të cilët iu përgjigjën pyetjes, "*Pse është më mire baraz?*". Kjo video ndërgjegjësuere u përgatit në Nëntor dhe është shpërndarë në mediat sociale për 16 ditët e aktivizmit. Lidhja e publikimit në Youtube: <https://youtu.be/YbqV6ZrWiHs>

Fotografitë gjatë xhirimit të videos ndërgjegjësuere:



- + **Aktivitet ndërgjegjësuere më 25 Nëntor 2019.** Kjo ngjarje kryesore e ndërgjegjësimit ishte në përputhje dhe pjesë e aktiviteteve të mbajtura gjatë 16 ditëve të aktivizmit dhe kërkoi mbështetje dhe bashkëpunim nga shumë palë të interesuara në Qarkun e Elbasanit, përfshirë përfaqësues të institucioneve publike dhe jopublike, shkolla të mesme, universitet, OJQ, anëtarë të komunitetit dhe media. Në *Ditën Ndërkombëtare Kundër Dhunës, 25 Nëntor*, Forumi i Gruas Elbasan, në partneritet me Bashkinë Elbasan dhe Zyrën Arsimore Vendore zhvilluan një marshim kundër dhunës në sheshin kryesor të qytetit dhe një aktivitet ndërgjegjësimi me përfaqësues të institucioneve, OJQ-ve, të rinjve nga shkollat e mesme, studentë dhe media në Teatrin Skampa nën moton **#MëMirë**=

Ky aktivitet synonte të promovonte vlerat e barazisë dhe mosdiskriminimit në ndryshimin e mendjeve të vjetruara dhe stereotipeve të dëmshme gjinore. Gjatë aktivitetit, agjentët e ndryshimit të komunitetit ndanë me pjesëmarrësit mesazhet e tyre përse ata besojnë se është më e mirë baraz dhe çfarë duhet të bëjmë për të arritur barazinë.



- + **11 Dhjetor 2019;** Në përmbyllje të **16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës** Forumi i Gruas Elbasan në bashkëpunim me aktorët lokalë vendosi të bashkohet për të ndezur dritat e shpresës për një të ardhme më të mirë. Qirinj në formën e një zemre dhe me shkrimin "**Dritë për jetën**" u vendosën në sheshin kryesor të Elbasanit, përpara Teatrit Skampa. Me përfaqësuesit e institucioneve, qytetarët e thjeshtë, miqtë dhe përkrahësit kujtuam jetët e humbura për shkak të dhunës dhe dhamë mesazhe ndërgjegjësimi. Qytetarët na mbështetën dhe donin të ndiznin qirinj në mbështetje të çështjes. Media lokale ishte e pranishme në aktivitet. Mesazhet e ndërgjegjësimit u ndanë dhe në mediat sociale.



### c. Trajnime

Në kuadër të projektit “Akses i përmirësuar për gratë dhe vajzat të mbijetuara të dhunës në Rajonin e Elbasanit” i financuar nga UN Women nëpërmjet United Nations Trust Fund. [#UNTF](#), FGE ka realizuar trajnime me aktorë të ndryshëm lokal si: përfaqësues institucionesh dhe ofruesit direkt të shërbimeve, për tema të cilat kanë patur në qendër çështjet gjinore, trajtimin e të mbijetuarve të dhunës të renditura si më poshtë:

- ✚ **Trajnim një ditor për ngritje kapaciteti me profesionistë të shëndetësisë të *Bashkive Librazhd* dhe *Prrenjas* me datë 29/05/2019 në ambjentet e Qendrës Shëndetësore Librazhd dhe të Bashkive Cërrik, Gramsh, Belsh, Peqin me datë 15/11/2019 në ambjentet e Qendrës Shëndetësore Cërrik.** Qëllimi i trajnimit ishte si profesionistët e shëndetësisë (kryesisht mjekë familje) të asistojnë më mirë të mbijetuarit e dhunës në familje në Bashkitë respektive. U diskutua mbi ndryshimet e reja në ligjin Nr 47/2018” Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar. Një rëndësi shumë e madhe ju kushtua detyrimeve ligjore që struktura e Ministrisë së Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale ka në zbatim të ligjit të mësipërm dhe sesi mund të përmirësohet menaxhimi i rasteve të të mbijetuarve të dhunës. Në eksperiencën e punës së përditëshme të FGE nuk kemi pothuaj asnjë rast që këto struktura të paraqesin nje raport për një viktimë dhune. Ky raport është shumë i rëndësishëm në sigurimin e provave në një proces gjyqësor. Ky takim shërbeu gjithashtu për të ndarë eksperiencën të mira dhe për të forcuar bashkëpunimin në të ardhmen.



Foto nga trajnimi i Profesionistëve të Mjekësisë të Bashkive Librazhd dhe Prrenjës



Foto nga trajnimi I Profesionistëve të Mjekësisë të Bashkive Cërrik, Gramsh, Belësh, Peqin

- Trajnim një ditor për ngritje kapaciteti të Administratorëve të Njësive Administrative të Bashkive Librazhd dhe Prrenjës 09.04.2019** në sallën e Këshillit Bashkiak Librazhd si dhe të Bashkive Cërrik, Gramsh, Belsh, Peqin **14.11.2019** në ambjentet e Këshillit të Bashkisë Cërrik. Qëllimi I trajnimit ishte si Administratorët e Njësive Administrative ti asistojnë më mirë të mbijetuarit e dhunës në familje në Bashkitë respektive konform ligjit Nr 47/2018” Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar. Në trajnim u diskutua mbi ndryshimet e reja në ligjin e dhunës, detyrimet që rrjedhin nga ky ligj për Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe sesi mund të përmirësohet menaxhimi i rasteve të të mbijetuarve të dhunës. Ky takim shërbeu gjithashtu për të ndarë eksperiencën të mirë dhe për të forcuar bashkëpunimin në të ardhmen.





Foto nga trajnimi i Administratorëve të Njesive Administrative të Bashkive Librazhd dhe Prrenjas



Foto nga trajnimi I Administratorëve të Njesive Administrative të Bashkive Cërrik, Gramsh, Belësh, Peqin

- ✚ **Trajnim për ngritje kapaciteti** të specialistëve të Policisë së Zonës:
  - të Bashkive Librazhd dhe Prrenjas me datë **15.04.2019** në ambjentet e Komisarariatit të Policisë Librazhd
  - të Bashkive Cërrik, Gramsh, Belsh dhe Peqin me datë **13.11.2019** në ambjentet e Komisarariatit të Policisë Cërrik

Qëllimi I trajnimit ishte të ndërtonim kapacitete tek këto struktura shumë të rëndësishme si ti asistojnë më mirë të mbijetuarat e dhunës në familje në Bashkitë e tyre respektive. U diskutua mbi ndryshimet e reja në ligjin Nr 47/2018” Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar. Një rëndësi shumë e madhe ju kushtua detyrimeve ligjore që struktura e Policisë së Shtetit ka jo vetëm në zbatim të ligjit të mësipërm por edhe në zbatim të Udhëzimit të përbashkët i Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 912, datë 27.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e urdhrimit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme” Tashmë Policia e Shtetit për 48 orë merr shumë kompetenca sidomos në ditë të Shtunë dhe të Djelë. Duke qenë se deri më sot Policia e Shtetit hap online një UM/UMM u kalua në aplikimin online të UM/UMM pasi shumë SPZ që nuk kishin akses në internet nuk e kishin aplikuar në punën e tyre të përditëshme. Këto SPZ patën shansin e madh që përmes këtij trajnimi të njihen pothuaj të parët dhe në nivel kombëtar për ndryshimet e reja ligjore për dhunën në familje.

Në trajnim u diskutua mbi ndryshimet e reja në ligjin e dhunës, detyrimet që rrjedhin nga ky ligj për e dhunës, detyrimet që rrjedhin nga ky ligj për secilin prej aktorëve dhe sesi

mund të përmirësohet menaxhimi i rasteve të të mbijetuarve të dhunës. Ky takim shërbeu gjithashtu për të ndarë eksperiencën të mirë dhe për të forcuar bashkëpunimin në të ardhmen.



Foto nga trajnimi i Specialistëve të Policisë së Zonës të Bashkive Librazhd dhe Prrenjas



Foto nga trajnimi i Specialistëve të Policisë së Zonës të Bashkive Cërrik, Gramsh, Belsh, Peqin

Një falenderim të vecantë për angazhimin e Policisë Vendore Elbasan në organizmin sa më të mirë të këtyre trajnimeve. Shefi i Burimeve Njerzore, **Z. Maksi Andoni** pranë kësaj strukture ndoqi në Cërrik direkt këtë trajnim për të parë pjesmarrjen e SPZ-ve në trajnimim dhe interesin e tyre.

- ✚ **Tryezë e rumbullakët në përmbyllje të projektit të Policimit në Komunitet;** Në fund të projektit u realizua tryeza e rumbullakët me 30 përfaqësuesit e pushtetit vendor (17 femra dhe 13 meshkuj), organizatat partnere, media, të rinjtë të përfshirë në projekt, etj., ku u ndanë rezultatet e arritura në këtë projekt duke theksuar rëndësinë e dialogut dhe partneriteteve dhe bashkëpunimit me policinë, bashkinë dhe aktorët e tjerë lokal për parandalimit/reduktimit e dhunës në familje dhe sigurisë qytetare.



- Workshop dy-ditor** në kuadër të projektit të mbështetur nga AWEN me aktorë vendorë (psikologë / punonjës socialë / jurist) të 6 Bashkive të Qarkut Elbasan (Peqin, Cerrik, Belsh, Gramsh, Librazhd dhe Prrrenjas) se si të menaxhohen shërbimet për të mbijetuarit e DHF dhe DBGJ; Ky workshop dha konceptet thelbësore se si të ndërtojnë dhe mirëmbajnë shërbime për të mbijetuarit e dhunës, veçanërisht ato që vijnë nga zonat rurale. Ai gjithashtu siguroi informacione për detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin "Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar dhe për mënyrën e plotësimit të urdhrimit të mbrojtjes ose urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes. Konventa CEDAW dhe standardet e strehëzave emergjente u diskutuan me pjesëmarrësit dhe mundësitë e mëtejshme për të hapur shërbime për komunitetin në secilën bashki.



- 6 Sesione për ngritje kapaciteti** me administratore sociale, infermieret dhe SPZ-te në njesite administrative Labinot, Shirgjan, Tregan, Paper, Shushice dhe Bradashesh të Bashkise Elbasan meqenese jane personat e pare qe presin dhe identifikojne nje rast dhune. Zhvillimi i ketyre sesioneve kishte per qellim te permiresoje sherbimet qe i ofrohen komunitetit nga aktoret lokale te siperpermendur. Ne sesionet ishin ne total 53 pjesemarrres (37 gra dhe 16 burra)



- ✚ **Workshop me aktorët lokalë** në kuadër të projektit të mbështetur nga UN Women me përfaqësuesit e Institucioneve Publike dhe Organizatave të Shoqërisë Civile me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit për të minimizuar efektet dhe për të parandaluar fenomenin e dhunës me bazë gjinore; në mbështetjen me shërbime konkrete rehabilituese e integruese të grave/vajzave të mbijetuara nga dhuna nga familje; në rritjen e përgjegjësisë së secilit prej nesh për të qenë larg mentalitetit paragjykses për një grua të dhunuar në gjithë format vecanërisht të përdhunimit/dhunës seksuale.



- ✚ **Supervizimi i stafit / retreat;** Gjatë Prillit 2019 stafi i FGE realizoi retreat-in sipas parashikimit në projekt. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte shmangia e burn-out të stafit dhe ndikon pozitivisht në vazhdimësinë e punës me gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës.



---

FGE për realizimin e objektivave të saj bashkëpunon me institucione shtetërore në nivel qendror/lokal si dhe me shumë organizata partnere, ku mund të përmendim: Tjetër Vizion, Në Dobi të Komunitetit, World Vizion, etj.

Disa nga institucionet shtetërore me të cilat FGE ka marrëveshje bashkëpunimi janë:

- Këshilli i Qarkut Elbasan;
- Zyra Vendore Arsimore Elbasan;
- Drejtoria e Policisë së Qarkut Elbasan (DPQE);
- Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë (DRSH), Elbasan;
- Bashkia Elbasan;
- Bashkia Cerrik;
- Bashkia Librazhd;
- Bashkia Prrenjas;
- Bashkia Belsh;
- Bashkia Gramsh;
- Bashkia Peqin;

Gjithashtu, FGE ka një partneritet të zgjeruar me organizata e rrjete kombëtare e ndërkombëtare si më poshtë:

- Komiteti Rajonal Antitrafik (KRAT);
- Komiteti Drejtues dhe Ekipi Teknik për “Mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e proçedimit të tij”;
- Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN);
- Women Against Violence Europe (WAVE) - Pikë fokale për Shqipërinë.